



Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. _____, datë _____

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 54/2024 “PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”¹

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

Në ligjin Nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në shkronjën c) të pikës 1, të nenit 5, pas paragrafit v., shtohet paragrafi v., me këtë përmbajtje:

“v. krijimin dhe zhvillimin e rrjeteve trans-evropiane, ofrimin, disponueshmërinë dhe ndërveprimin e shërbimeve pan-evropiane.”

Neni 2

Në nenin 13, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në fund të pikës 3, fjalët: “përfshirë pjesëmarrjen në BEREC” zëvendësohen me fjalët: “përfshirë pjesëmarrjen e plotë në punët e strukturave organizative të BEREC”.
2. Pika 10, riformulohet si më poshtë: “10. AKEP mbështet objektivat e BEREC dhe gjatë miratimit të vendimeve të tij merr parasysh maksimalisht udhëzimet, opinionet, rekomandimet, qëndrimet e përbashkëta, praktikat më të mira dhe metodologjitë e miratuara nga BEREC, për të siguruar zbatimin e qëndrueshëm të kuadrit rregullator në lidhje me objektivat e BEREC mbi roamingun e rrjeteve të komunikimeve elektronike të lëvizshme brenda BE, aksesin në internetin e hapur dhe sipas Kodit Evropian për Komunikimet Elektronike. Në rastet e devijimit nga udhëzimet e BEREC, në veçanti ato që lidhen me çështjet rregullatore ndërkufitare që ndikojnë në një numër të madh vendesh anëtare të Bashkimit Evropian, AKEP jep arsyet përkatëse”.

¹ Ky projektakt është i përafëruar pjesërisht me Rregulloren e (BE) 2018/1971 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 dhjetor 2018, për themelimin e Organit të Rregullatorëve Evropianë për Komunikimet Elektronike (BEREC) dhe të Agjencisë për Mbështetjen e BEREC (Zyra BEREC), duke ndryshuar Rregulloren (BE) 2015/2120 dhe duke shfuqizuar Rregulloren (KE) nr. 1211/2009; Numri CELEX 32018R1971, Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 321, date 17.12.2018, p. 1–35

Neni 3

Në fund të pikës 6, të nenit 16, shtohet fjalia: “Kundër vendimit të shkarkimit mund të bëhet ankim në Gjykatë sipas legjislacionit në fuqi”.

Neni 4

Pas nenit 25, shtohen nenet 25/1, 25/2 dhe 25/3 me këtë përmbajtje:

Neni 25/1

Bashkëpunimi me BEREC dhe organet rregullatore në shtetet anëtare të BE

1. *AKEP bashkëpunon me BEREC, si dhe organet rregullatore të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, për zhvillimin e tregut të përbashkët ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, në fushën e komunikimeve elektronike.*
2. *AKEP bashkëpunon në veçanti me BEREC, për identifikimin e instrumentave dhe masave rregullatore të nevojshme për kushtet e tregut të komunikimeve elektronike. AKEP mbështet objektivat e BEREC për arritjen e koordinimit më të mirë dhe rregullimin e harmonizuar të shërbimeve roaming midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, mbi bazën e marrëveshjes përkatëse për rregullimin e shërbimeve roaming.*
3. *AKEP cakton anëtarët dhe zëvendësuesit e tyre në Bordin e Rregullatorëve dhe Bordin e Menaxhimit të BEREC, sipas përcaktimeve në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.*

Neni 25/2

Zbatimi i rregullimit të roaming midis Republikës së Shqipërisë dhe BE

1. *Rregullimi i shërbimeve të roaming-ut midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, bëhet sipas një kuadri të harmonizuar/të përbashkët për rregullimin e shërbimeve të roaming-ut, midis Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në Rregulloren e Bashkimit Evropian për roaming-un në rrjetet publike të komunikimeve elektronike të lëvizshme.*
2. *Niveli i tarifave të roaming-ut, si dhe rregullat e përdorimit të drejtë për roaming-un si në shtëpi me Bashkimin Evropian, miratohen me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP sipas rregullores përkatëse të Bashkimit Evropian dhe kuadrit të harmonizuar/të përbashkët për rregullimin e shërbimeve të roaming-ut midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian.*

25/3

Shkëmbimi i informacionit me BEREC

1. *Me kërkesë të arsyeshme të BEREC, ose Zyrës së BEREC, AKEP dhe autoritetet e tjera kompetente në zbatim të këtij ligji, i sigurojnë BEREC ose Zyrës së BEREC, të gjithë informacionin e nevojshëm, në mënyrë të drejtë dhe të saktë, për të kryer detyrat e tyre, me kusht që ata të kenë qasje ligjore në informacionin përkatës dhe që kërkesa për informacion të jetë e nevojshme në lidhje me natyrën e detyrës në fjalë. BEREC ose Zyra e BEREC, mund të kërkojë gjithashtu që ky informacion të sigurohet në mënyrë periodike dhe sipas formateve të përcaktuara nga BEREC. Kur është e mundur, këto kërkesa bëhen sipas formateve të zakonshme të raportimit.*
2. *Me kërkesë të arsyeshme të AKEP, BEREC ose Zyra e BEREC, sigurojnë, në mënyrë të drejtë dhe të saktë, çdo informacion që është i nevojshëm për të mundësuar që AKEP, ose dhe autoritetet e tjera kompetente në zbatim të këtij ligji, të kryejnë detyrat e tyre, në përputhje me parimin e bashkëpunimit të singertë. Kur BEREC ose Zyra e BEREC, konsideron një*

informacion si konfidencial, AKEP ose çdo autoritet tjetër kompetent, duhet të sigurojë konfidencialitetin në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe legjislacionin kombëtar për ruajtjen e sekretit tregtar të biznesit, pa penguar shkëmbimin e informacionit në kohë.

3. Kur informacioni nuk sigurohet në kohë nga AKEP, BEREC ose Zyra e BEREC, mund të drejtojë një kërkesë të arsyeshme tek organet e tjera rregullatore, autoritetet e tjera kompetente të shtetit anëtar përkatës, ose drejtpërdrejt tek sipërmarrësit përkatës që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimit elektronik, apo facilitetet shoqëruese.
4. BEREC ose Zyra e BEREC, njoftojnë AKEP nëse nuk kanë siguruar informacionin për kërkesat në përputhje me paragrafin e parë. Me kërkesë të BEREC ose Zyrës së BEREC, AKEP ndihmon BEREC në mbledhjen e informacionit të kërkuar.
5. AKEP dhe autoritetet e tjera kompetente në zbatim të këtij ligji kanë të drejtë të kërkojnë nga autoritetet e tjera kombëtare përgjegjëse ose sipërmarrjet që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike, apo facilitete shoqëruese, që të paraqesin të gjithë informacionin e nevojshëm për të kryer detyrat e tyre të përmendura në këtë nen.
6. Autoritetet e tjera kombëtare përgjegjëse ose sipërmarrësit, siç përmendet në paragrafin e parë të këtij neni, duhet të sigurojnë informacionin menjëherë me marrjen e kërkesës dhe në përputhje me afatet dhe nivelin e detajimit të kërkuar.
7. Në rastet e nevojshme si në mospërmbushje të kërkesës për informacion nga sipërmarrësit, AKEP merr masa administrative sipas parashikimeve në këtë ligj që janë të përshtatshme, efektive, proporcionale dhe parandaluese.

Neni 5

Në nenin 42, bëhen këto ndryshime:

1. Në fund të shkronjës gj) të pikës 1, shtohet fjalia: “BEREC përgatit formularë për plotësimin e informacionit të kërkuar, kur është e nevojshme për të lehtësuar paraqitjen e informacionit dhe kryerjen e analizës së konsoliduar”.
2. Në fund të pikës 4, shtohet fjalia: “Si dhe nuk publikon kërkesat për informacion nëse ai është bërë paraprakisht i disponueshëm nga BEREC, sipas përcaktimeve në nenin 25/3 të këtij ligji, kur BEREC e ka marrë këtë informacion nga këto autoritete”.

Neni 6

Pas nenit 100, shtohet neni 100/1 me kete permbajtje:

Neni 100/1

Tarifat e terminimit për zbatimin e RLAH me BE

1. Tarifat e terminimit të thirrjeve zanore për përdoruesit fundorë në rrjetet e tyre të lëvizshme dhe fikse, të aplikuara nga ofruesit e shërbimit të komunikimeve elektronike për terminimin e thirrjeve zanore për thirrjet kombëtare dhe thirrjet që origjinohen nga numra të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, nuk duhet të tejkalojnë tarifën maksimale të vetme (Eurotarifën), të përcaktuar në nivelin e Bashkimit Evropian, për terminimin e thirrjeve zanore në rrjetet e lëvizshme dhe, përkatësisht tarifën maksimale të vetme në nivelin e Bashkimit Evropian për terminimin e thirrjeve zanore në rrjetet fikse.
2. Nëse Komisioni Evropian vendos të mos aplikojë një tarifë maksimale të terminimit të thirrjeve zanore në rrjetet e lëvizshme ose një tarifë maksimale të terminimit të thirrjeve zanore në rrjetet fikse, ose asnjërin prej tyre, AKEP kryen analiza të tregjeve të terminimit të thirrjeve zanore, në përputhje me Nenin 90, me qëllim që të vlerësojë nëse detyrimet rregullatore janë të nevojshme.

3. Nëse, pas një analize të tregut të parashikuar në paragrafin 2, të këtij neni, AKEP vendos, për thirrjet kombëtare dhe thirrjet që origjinohen nga numrat e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, tarifa të terminimit të thirrjeve zanore bazuar në kosto, mbi bazën e kriterëve për përcaktimin e tarifave me shumicë të terminimit të thirrjeve zanore në tregjet e telefonisë fikse dhe të lëvizshme, të përcaktuara në lidhjen 2, bashkëlidhur këtij ligji. Propozimet për masat rregullatore i nënshtrohen procedurave të konsultimit dhe transparencës sipas përcaktimve në nenin 44, të këtij ligji.
4. AKEP monitoron dhe siguron përmbushjen nga ofruesit e shërbimeve të terminimit të thirrjeve zanore të detyrimit të përcaktuar në paragrafin 1, të këtij neni. AKEP mundet, në çdo kohë, t'i kërkojë një ofruesi të shërbimeve të terminimit të thirrjeve zanore përdoruesve fundorë në rrjetet e veta mobile ose fikse të modifikojë tarifën për ato shërbime, të cilën e aplikon për ofruesit e tjerë për thirrjet kombëtare dhe thirrjet që origjinohen nga numrat e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, nëse ajo tejkalon tarifën përkatëse të përcaktuar në nivelin e Bashkimit Evropian në përputhje me paragrafin 1, të këtij neni.
5. Kur tarifat e terminimit të aplikuara nga ofruesit e shërbimeve për thirrjet kombëtare dhe thirrjet që origjinohen nga numrat në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, janë vendosur në një monedhë tjetër përveç euros, tarifat maksimale të terminimit të thirrjeve zanore në rrjetet e lëvizshme dhe fikse të përmendura në paragrafin 1, të këtij neni, do të konvertohen në monedhën kombëtare, bazuar në mesataren më të fundit të kurseve të këmbimit referues të publikuara më 1 shtator, 1 tetor dhe 1 nëntor nga Banka Qendrore Evropiane në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian. Tarifat maksimale të terminimit të thirrjeve zanore në rrjetet e lëvizshme dhe fikse, të konvertuara në monedhën kombëtare, do të rishikohen çdo vit dhe përditësohen në 1 janar të çdo viti, duke përdorur mesataren më të fundit të kurseve të këmbimit referues të publikuara më 1 shtator, 1 tetor dhe 1 nëntor nga Banka Qendrore Evropiane në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.
6. AKEP informon BEREC çdo vit për zbatimin e këtij Neni. Ky informacion i vihet në dispozicion edhe Komisionit Evropian.

Neni 7

Në fund të shkronjës c, të pikës 1, të nenit 184 shtohet paragrafi:

“xvii. Nuk zbaton vendimin e AKEP për rregullimin e shërbimeve të roaming-ut”.

Neni 8

Neni 188 shfuqizohet.

Neni 9

Dispozita kalimtare

Zbatimi i neneve 4 dhe 6, sipas këtij ligji fillon në datën e dakordësuar në marrëveshjen dypalëshe për rregullimin e shërbimit roaming midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian.

Neni 10

Hyrja ne fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

NIKO PELESHI

AKEP merr pjesë në organet e BEREC si më poshtë:

- a) Bordi i Rregullatorëve
- b) Bordi i Menaxhimit
- c) Zyra e Punës e BEREC

I. Përbërja e Bordit të Rregullatorëve

1. Bordi i Rregullatorëve i BEREC përbëhet nga një anëtar nga secili shtet anëtar. Çdo anëtar ka të drejtë vote dhe caktohet nga Autoriteti Rregullator Kombëtar (ARK) që ka përgjegjësinë kryesore për mbikëqyrjen e funksionimit të përditshëm të tregjeve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike sipas Direktives (BE) 2018/1972. Anëtarit caktohet nga rradhët e drejtuesve të ARK-së, anëtarët e organit të saj kolegjal, ose zëvendësuesit e cilitdo prej tyre.
2. Çdo anëtar i Bordit të Rregullatorëve duhet të ketë një zëvendësues, të caktuar nga ARK. Zëvendësuesi duhet të përfaqësojë anëtarin në mungesë të tij/saj. Zëvendësuesi i anëtarit caktohet nga rradhët e drejtuesve të ARK, anëtarët e organit të saj kolegjal, zëvendësuesit të cilitdo prej tyre, ose stafit të ARK-së.
3. Anëtarët e Bordit të Rregullatorëve dhe zëvendësuesit e tyre, caktohen mbi bazën e njohurive të tyre në fushën e komunikimeve elektronike, duke marrë në konsideratë aftësitë përkatëse menaxheriale, administrative dhe buxhetore. Për të siguruar vazhdimësinë e punës së Bordit të Rregullatorëve, të gjitha ARK-të përkatëse, duhet të bëjnë përpjekje për të kufizuar ndërrimin e anëtarëve të tyre dhe, kur është e mundur, edhe të zëvendësuesve të tyre, dhe të synojnë arritjen e një përfaqësimi të balancuar ndërmjet burrave dhe grave.

II. Pavarësia e Bordit të Rregullatorëve

1. Kur ushtron detyrat që i janë dhënë dhe pa paragjykuar faktin që anëtarët e saj veprojnë në emër të ARK-ve përkatëse, Bordi i Rregullatorëve duhet të veprojë në mënyrë të pavarur dhe objektive në interes të Bashkimit, pavarësisht nga çdo interes i veçantë kombëtar ose personal.
2. Pa paragjykuar koordinimin sipas përcaktimeve në paragrafin 6 të nenit 3, të Rregullores BE 2018/1971, anëtarët e Bordit të Rregullatorëve dhe zëvendësuesit e tyre, nuk duhet të kërkojnë dhe as të marrin udhëzime nga asnjë qeveri, institucion, person apo organ.

III. Mbledhjet e Bordit të Rregullatorëve

Anëtarët dhe zëvendësuesit e Bordit të Rregullatorëve mund, në përputhje me rregulloren e brendshme të tij, të asistohen në mbledhje nga këshilltarët ose ekspertë të tjerë.

IV. Rregullat e votimit në Bordin e Rregullatorëve

Çdo anëtar ka një votë. Në mungesë të një anëtarit, zëvendësuesi ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e votës së atij anëtarit. Në mungesë të një anëtarit dhe zëvendësuesit, e drejta e votës mund t'i delegohet një anëtarit tjetër. Kryetari mund të delegojë të drejtën e votës në çdo rast. Kryetari duhet të marrë pjesë në votim, përveçse kur ai ose ajo ka deleguar të drejtën e votës.

V. Përbërja e Bordit të Menaxhimit

1. Bordi i Menaxhimit përbëhet nga personat e emëruar si anëtarë të Bordit të Rregullatorëve dhe nga një përfaqësues i nivelit të lartë i Komisionit. Çdo anëtar i Bordit të Menaxhimit duhet të ketë të drejtë vote. Çdo Autoritet Rregullator Kombëtar (ARK) që bën emërimin, siç përmendet në nënparagrafin e dytë të pikës I, mund të emërojë një person tjetër, përveç anëtarit të Bordit të Rregullatorëve, si anëtar të Bordit të Menaxhimit. Ky person duhet të jetë drejtuesi i ARK-së, një anëtar i organit të saj kolegjal, ose zëvendësuesi i cilitdo prej tyre.
2. Çdo anëtar i Bordit të Menaxhimit duhet të ketë një zëvendësues që e përfaqëson anëtarin në mungesë të tij ose të saj. Zëvendësuesit e çdo anëtari duhet të jenë personat e emëruar si zëvendësues të anëtarëve të Bordit të Rregullatorëve. Përfaqësuesi i Komisionit duhet të ketë gjithashtu një zëvendësues.
Çdo ARK që bën emërimin, siç përmendet në nënparagrafin e dytë të pikës I të kësaj lidhjeje, mund të emërojë një person tjetër, përveç zëvendësuesit të anëtarit të Bordit të Rregullatorëve, si zëvendësues të anëtarit të Bordit të Menaxhimit. Ky person duhet të jetë drejtuesi i ARK, një anëtar i organit të saj kolegjal, zëvendësuesi i cilitdo prej tyre, ose një pjesëtar i stafit të ARK-së.
3. Anëtarët e Bordit të Menaxhimit dhe zëvendësuesit e tyre, nuk duhet të kërkojnë apo marrin udhëzime nga asnjë qeveri, institucion, person apo organ.

VI. Pjesëmarrja në mbledhjet e Bordit të Menaxhimit

Anëtarët e Bordit të Menaxhimit dhe zëvendësuesit e tyre mund, në përputhje me rregulloren e brendshme të tij, të asistohen në mbledhje nga këshilltarë ose ekspertë.

VII. Konfidencialiteti

Anëtarët dhe pjesëmarrësit e tjerë në mbledhjet e Bordit të Rregullatorëve, Bordit të Menaxhimit dhe grupeve të punës, Drejtori, ekspertët kombëtarë të caktuar dhe stafi tjetër që nuk punojnë në Zyrën e BEREC, duhet të respektojnë kërkesat për konfidencialitet sipas Nenit 339 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU), edhe pasi detyrat e tyre të kenë përfunduar.

VIII. Deklaratat e interesave

1. Anëtarët e Bordit të Rregullatorëve dhe Bordit të Menaxhimit, Drejtori, ekspertët kombëtarë të dërguar dhe stafi tjetër jo i punësuar nga Zyra e BEREC, duhet që secili të bëjë një deklaratë të shkruar që tregon angazhimet e tyre dhe mungesën ose praninë e çdo interesi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që mund të konsiderohet se cënon pavarësinë e tyre.
Këto deklarata duhet të bëhen në momentin e marrjes së përgjegjësisë, të jenë të sakta dhe të plota, dhe duhet të përditësohen kur ekziston rreziku i ndonjë interesi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që mund të konsiderohet se cënon pavarësinë e personit që bën deklaratën.
Deklaratat e bëra nga anëtarët e Bordit të Rregullatorëve, anëtarët e Bordit të Menaxhimit dhe Drejtori, bëhen publike.
3. Anëtarët e Bordit të Rregullatorëve, Bordit të Menaxhimit dhe grupeve të punës, si dhe pjesëmarrësit e tjerë në mbledhjet e tyre, Drejtori, ekspertët kombëtarë të dërguar dhe stafi tjetër jo i punësuar nga Zyra e BEREC, duhet secili të deklarojë saktë dhe plotësisht, së paku në fillim të çdo mbledhjeje, çdo interes që mund të konsiderohet se cënon pavarësinë e tyre në lidhje me pikat e agjendës, dhe duhet të përmbahen nga pjesëmarrja në diskutim dhe votim mbi këto pika.

Kriteret për përcaktimin e tarifave të terminimit me shumicë të thirrjeve zanore

1. Kriteret për përcaktimin e tarifave me shumicë të terminimit të thirrjeve zanore në tregjet e telefonisë fikse dhe të levizshme, për zbatimin e parashikimeve në nenin 100/1, të këtij ligji janë si më poshtë:

- a) tarifat bazohen në mbulimin e kostove të një operatori eficient; vlerësimi i kostove efiente dhe në vlerat aktuale të kostos; metodologjia e kostos për llogaritjen e kostove efiente bazohet në modelin “bottom-up” duke përdorur kostot rritëse afatgjata (LRIC) të lidhura me trafikun për ofrimin e shërbimit të terminimit të thirrjeve zanore me shumicë për palët e treta;
- b) kostot perkatese rritëse afatgjata (LRIC), të shërbimeve të terminimit të thirrjeve zanore me shumicë, do të përcaktohen si diferenca midis kostove totale afatgjata të një ofruesi që ofron gamën e tij të plotë të shërbimeve dhe kostove totale afatgjata të atij ofruesi kur ai nuk ofron një shërbim me shumicë të terminimit të thirrjeve zanore për palë të treta;
- c) vetëm kostot e lidhura me trafikun, të cilat do të shmangeshin në mungesë të ofrimit të një shërbimi zanor me shumicë, i alokohen rritjes përkatëse të përfundimit;
- d) kostot që lidhen me kapacitetin shtesë të rrjetit do të përfshihen vetëm në masën që ato janë të nxitura nga nevoja për të rritur kapacitetin për qëllimin e bartjes së trafikut shtesë të terminimit me shumicë të zërit;
- e) tarifat e spektrit të radios do të përjashtohen nga kostot rritëse të terminimit të thirrjeve zanore në rrjetin celular;
- f) do të përfshihen vetëm ato kosto komerciale me shumicë që lidhen drejtpërdrejt me ofrimin e shërbimit të ndërprerjes së zërit me shumicë tek palët e treta;
- g) të gjithë operatorët e rrjetit fiks do të konsiderohet se ofrojnë shërbime të terminimit zanor me të njëjtat kosto njësi si operatori efikas, pavarësisht nga madhësia e tyre;
- h) për operatorët e rrjeteve celulare, shkalla minimale efikase do të vendoset në një pjesë tregu jo më të ulët se 20 %;
- i) qasja përkatëse për zhvlerësimin e aktivitetit do të jetë amortizimi ekonomik; dhe
- j) zgjedhja e teknologjisë së rrjeteve të modeluara do të jetë me shikim përpara, bazuar në një rrjet bazë IP, duke marrë parasysh teknologjitë e ndryshme që mund të përdoren gjatë periudhës së vlefshmërisë së normës maksimale; në rastin e rrjeteve fikse, thirrjet do të konsiderohen të jenë ekskluzivisht me komutim të paketave.